VENDIM
Nr.682, datë 11.10.2006

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 407, DATË 21.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.407, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën "a", emërtesa "Inspektorati i Instituteve të Pensioneve Suplementare" shfuqizohet dhe në fund të kësaj shkronje, shtohet emërtesa "Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave".

b) Në fund të shkronjës "b" shtohen emërtesat "Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë, Tiranë dhe Inspektorati Qendror Teknik".

c) Në shkronjën "c", emërtesat "Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike" dhe "Inspektorati i Pajisjeve nën Presion" shfuqizohen dhe, në fund të kësaj shkronje, shtohen emërtesat "Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve","Klubi Shumësportësh "Partizani"" dhe "Federatat e sportit".

2. Në pikën 2/2, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Lidhja nr.1/2 zëvendësohet me lidhjen, me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pas pikës 2/2 shtohen pikat 2/3 dhe 2/4, me këtë përmbajtje:

"2/3. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet "specialist" deri në "Titullar i institucionit", për ALUIZNI-n, të jenë sipas lidhjes nr. 1/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2/4. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet "specialist" deri në "Titullar i institucionit", për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të jenë sipas lidhjes nr. 1/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

3. Në pikën 3/1 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 3/1 riformulohet, si më poshtë vijon:

"3/1. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet "specialist" deri në "Titullar i institucionit" në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, Kompaninë Shtetërore të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe në Kompaninë Teatrore Shtetërore Qendrore të Teatrit Kombëtar për Fëmijë, të jenë sipas lidhjes nr. 2/1-a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, Kompaninë Shtetërore të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe në Kompaninë Teatrore Shtetërore Qendrore të Teatrit Kombëtar për Fëmijë, të jenë sipas lidhjes nr.2/1-b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit, që paguhen sipas lidhjes nr. 2/1-b, jepet në masën 2 për qind për çdo vit pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 10 050 lekë.

Punonjësit e trupës artistike të këtyre institucioneve përfitojnë shtesë për kushte pune, në masën 6000 lekë në muaj.".

b) Lidhja nr.2/1 e kësaj pike shfuqizohet.

4. Në pikën 5 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 5 riformulohet, si më poshtë vijon:

"5. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet "specialist" deri në "Titullar i institucionit", të institucioneve rajonale/vendore, në varësi të ministrave të linjës, të institucioneve rajonale/vendore, në varësi të institucioneve, të përcaktuara në pikën 1, si dhe të punonjësve, që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të jenë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

b) Lidhja nr.4 e kësaj pike, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Lidhja nr.4/1 e pikës 5/1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Pas pikës 5/3 shtohen pikat 5/4 e 5/5, me këtë përmbajtje:

"5/4 Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet "specialist" deri në "Titullar i institucionit" në zyrat rajonale/vendore të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), janë sipas lidhjes nr.4/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5/5. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet "specialist" deri në "Titullar i institucionit" në zyrat rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave janë sipas lidhjes nr. 4/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

7. Në pikat 6,7,8, e 9, lidhja nr.2/1 shfuqizohet dhe shtohen lidhjet nr.1/3, nr.1/4, nr.2/1-a, nr.2/1-b, nr.4/4 dhe nr.4/5.

8. Në lidhjen nr.2, emërtesat e trupës artistike, të përfshira në lidhjen nr.2/1-B, shfuqizohen.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë:

- për zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, nga data 1 korrik 2006;
- për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nga data 23 gusht 2006;
- për institucionet e tjera, që përfitojnë nga ky vendim, nga data 1 shtator 2006.

10. Efektet financiare të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1/2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3	4	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	10.050	2%	0	97.713	10.000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	10.050	2%	0	80.342	8.000
Drejtor drejtorie	III-a	10.050	2%	0	59.714	6.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	10.050	2%	0	49.942	6.000
Përgjegjës sektori	III-b	10.050	2%	0	43.428	0
Specialist Inspektor	IV-a	10.050	2%	0	32.571	5.000
Specialist	IV-a	10.050	2%	0	32.571	0

Lidhja nr.1/3

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE INFORMALE

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3	4	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	10.050	2%	0	97.713	13.000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	10.050	2%	0	80.342	13.000
Drejtor drejtorie Kordinator	III-a	10.050	2%	0	59.714	15.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	10.050	2%	0	49.942	10.000
Përgjegjës sektori Inspektor	III-b	10.050	2%	0	43.428	5.000
Specialist	IV-a	10.050	2%	0	32.571	10.000
	IV-b	10.050	2%	0	21.714	5.000

Lidhja nr.1/4

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale	Shtesa e	Shtesa për

		(Paga bazë)			pozicionit	kushte pune
		1	2	3	4	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	10.050	2%	0	97.713	13.000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	10.050	2%	0	80.342	13.000
Kordinator	III-a	10.050	2%	0	59.714	15.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	10.050	2%	0	49.942	10.000
Përgjegjës sektori Inspektor	III-b	10.050	2%	0	43.428	5.000
Specialist	IV-a	10.050	2%	0	32.571	10.000
	IV-b	10.050	2%	0	21.714	5.000

Lidhja nr.2/1-A

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT” NË TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS DHE BALETIT, KOMPANINË SHTETËRORE TË ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE POPULLORE DHE NË KOMPANINË TEATRORE, SHTETËRORE, QENDRORE TË TEATRIT KOMBËTAR PËR FËMIJË

	Paga mujore				
Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-b	10.050	2%	0	80.342
Zëvendëstitullar i institucionit Drejtor drejtorie	III-a	10.050	2%	0	59.714
Përgjegjës sektori	III-a/1	10.050	2%	0	49.942
Përgjegjës sektori	III-b	10.050	2%	0	43.428
Specialist Mjek	IV-a	10.050	2%	0	32.571
	IV-b	10.050	2%	0	21.714

Lidhja nr.2/1-B

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS DHE BALETIT, KOMPANINË SHTETËRORE TË ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE POPULLORE DHE NË KOMPANINË TEATRORE SHTETËRORE, QENDRORE TË TEATRIT KOMBËTAR PËR FËMIJË

I. Për Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor Solist i parë Koncertmaestër Baletmaestër Aktor i parë	59.992 lekë
2	Asistent dirigjent Asistent regjisor Solist II (Spala sektori) Aktor i dytë	53.478 lekë
3	Orkestrant i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Balerin i kategorisë së parë Aktor i tretë Skenograf i kategorisë së parë	42.621 lekë
4	Orkestrant i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Balerin i kategorisë së dytë Aktor i tretë Skenograf i kategorisë së dytë	31.764 lekë

II. Për Kompaninë Shtetërore të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe Kompaninë Teatrore Shtetërore Qendrore të Teatrit Kombëtar për Fëmijë

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor	53.478 lekë
2	Solist i parë Orkestrant i kategorisë së parë Aktor i parë Skenograf i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Valltar i kategorisë së parë	42.621 lekë
3	Solist i dytë Orkestrant i kategorisë së dytë Aktor i dytë Skenograf i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Valltar i kategorisë së dytë	31.764 lekë

Lidhja nr.4

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË INSTITUCIONEVE RAJONALE/VENDORE NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS, INSTITUCIONEVE RAJONALE/VENDORE NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE QENDRORE NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS, SI DHE TË PUNONJËSVE QË KRYEJNË FUNKSIONE TË DELEGUARA TË PUSHTETIT QENDROR NË PUSHTETIN VENDOR DHE SEKRETARËT E DEPUTETËVE

	Paga mujore		
Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (Paga bazë)	Shtesa e

					pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Kryetar i degëve rajonale i policisë elektrike	III-a	10.050	2%	0	59.714
Titullar i institucionit rajonal Kryetar i zyrës së përmbarimit Përgjegjës sektori në policinë elektrike në qarqe Inspektor në policinë elektrike në qarqe Përgjegjës seksioni në seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qarqe Kryeinspektor në inspektoratet e mbrojtjes së tokës në qarqe	III-b	10.050	2%	0	43.428
Titullar i institucionit vendor Përgjegjës sektori në institucionet rajonale Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Përmbarues gjyqësor në zyrat e përmbarimit gjyqësor Specialist në policinë elektrike në qarqe	IV-a	10.050	2%	0	32.571
Përgjegjës sektori i institucionit vendor Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar) Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Specialist në institucionet rajonale Restaurator arti Arkitekt	IV-b	10.050	2%	0	21.714

Inspektor në inspektoratin e mbrojtjes së tokës në qarqe					
Specialist në institucionet vendore Specialist i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar) Restaurator Instruktor Piktor Sekretar deputeti	IV-c	10.050	2%	0	16.286

Lidhja nr.4/1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË RRETHE

Pozicioni	**Kategoria**	**Paga individuale (Paga bazë)**			**Shtesa e pozicionit**	**Shtesa për kushte pune**
		1	**2**	**3**	**4**	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Regjistrues i Tiranës	III-a	10.050	2%	0	59.714	15. 000
Regjistrues i rretheve të kategorisë së I-rë	III-a/1	10.050	2%	0	49.942	16.500
Regjistruesi i rretheve të kategorisë së II-të Zëvendësregjistrues i rretheve të kategorisë së I-rë	III-b	10.050	2%	0	43.428	16.500
Zëvendësregjistrues në zyrat e kategorisë së II-të	IV-a	10.050	2%	0	32.571	16. 500
Përgjegjës sektori në zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë	IV-a	10.050	2%	0	32.571	10. 000
Përgjegjës sektori në zyrat e regjistrimit të kategorisë së II-të Specialist në zyrat	IV-b	10.050	2%	0	21.714	10.000

e regjistrimit të kategorisë së I-rë						
Specialist në zyrat e regjistrimit të kategorisë së II-të	IV-c	10.050	2%	0	16.286	6.000

Shënim: Zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë janë zyrat: Tiranë, Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Kavajë, Korçë, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Shkodër, Vlorë, Dibër dhe Sarandë.

Lidhja nr.4/4

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ZYRAVE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE INFORMALE, NË RRETHE

Pozicioni	**Kategoria**	**Paga individuale (Paga bazë)**			**Shtesa e pozicionit**	**Shtesa për kushte pune**
		1	**2**	**3**	**4**	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	III-b	10.050	2%	0	43.428	16.500
Përgjegjës sektori	IV-a	10.050	2%	0	32.571	10.000
Specialist në institucionet rajonale	IV-b	10.050	2%	0	21.714	10.000

Lidhja nr.4/5

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ZYRAVE RAJONALE TË AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Pozicioni	**Kategoria**	**Paga individuale (Paga bazë)**			**Shtesa e pozicionit**	**Shtesa për kushte pune**
		1	**2**	**3**	**4**	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	

Titullar i institucionit	III-b	10.050	2%	0	43.428	16.500
Përgjegjës sektori	IV-a	10.050	2%	0	32.571	10.000
Specialist në institucionet rajonale	IV-b	10.050	2%	0	21.714	10.000